

1. Informacion i përgjithshëm

Blessed Investment sh.p.k është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me NIPT L71423028S, në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në Njesinë Bashkiake nr 2, Rruga "Themistokli Gërmenji", prane RTSH, Kati i I, Tiranë.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 7,000,100 Lek dhe zotërohet nga ortakut i vetëm Besnik Leskaj.

Në 31 dhjetor 2020 shoqëria ka 1 punonjës. (2019: 1 punonjës)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit të cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3 Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, manaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2020	2019
Euro/LEK	123.70	121.77
USD/ LEK	100.84	108.64

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta

Blessed Investment Shpk njih të gjitha investimet e tij në sipërmarrjet e përbashkëta sipas modelit të koston në pasqyrat financiare individuale të investitorit. Njohja e investimeve bëhet me kosto pakësuar me ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi i njohur në përputhje me SKK 5 Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale.

Shpërndarjet e marra nga investimi do të njihen si të ardhura, pa marrë parasysh nëse shpërndarjet janë nga fitimet e njësisë ekonomike të kontrolluar bashkërisht të akumuluar para ose pas datës së blerjes.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.5. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Toka nuk amortizohet.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysht shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.9. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)**

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në bankë	70,105,893	2,437,249
Në lekë	27,787	1,054,333
Në monedhë të huaj	70,078,106	1,382,916
Mjete monetare në arkë	363,121	568,744
	<u>70,469,014</u>	<u>3,005,993</u>

5. Huadhënie ndaj palëve të lidhura

Huadhëniet ndaj palëve të lidhura afatgjatë dhe afatshkurtër më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Huadhënie afatshkurtër	271,446,092	222,405,652
Hua Afatshkurtër – Ortaku	18,555,000	18,265,500
Hua Afatshkurtër – Albanian Financial Institution	131,634,200	126,454,471
Hua Afatshkurtër – GBI shpk	25,378,160	-
Hua Afatshkurtër – Renew shpk	34,636,000	-
Hua Afatshkurtër - Blue TDI	-	43,590,081
Hua Afatshkurtër – ARC	39,534,000	14,612,400
Hua Afatshkurtër Ikons DOO	1,237,000	1,217,700
Hua Afatshkurtër - Abkons Serbia	17,318,000	15,221,250
Hua Afatshkurtër - Ikons Global Malta	3,153,732	3,044,250
Huadhënie afatgjatë	26,719,200	26,302,320
Hua Afatgjatë - Ikons Shqipëria	26,719,200	26,302,320
	<u>298,165,292</u>	<u>248,707,972</u>

6. Tatim fitimi i arkëtueshëm

Tatim fitimi i arkëtueshëm më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Tatim fitimi i parapaguar	107,140	107,140
	<u>107,140</u>	<u>107,140</u>

7. Aktive të prodhuara për shitje

Aktivitet e prodhuara për shitje më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Situacione ndërtimi nga investitorë	718,536,648	585,723,610
Taksa e infrastrukturës	106,842,286	103,751,599
Interesa kredie te perlllogaritura	2,441,150	2,441,150
	<u>827,820,084</u>	<u>691,916,359</u>

8. Të tjera të arkëtueshme

Të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Dividentë të arkëtueshëm	33,407,244	53,800,124
Kliente te tjere	61,231,500	-
TVSH e arkëtueshme	401,348	4,966
Llogari te tjera te arketueshme	415,272	-
	<u>95,455,364</u>	<u>53,805,090</u>

9. Investime në pjesëmarrje

Investime në shoqëri të kontrolluara detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Aksione Abkons 70% (31/12/19: 90%)	116,164,222	149,354,000
	<u>116,164,222</u>	<u>149,354,000</u>

10. Investime në shoqëri të kontrolluara

Investime në shoqëri të kontrolluara detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
100% Aksione Ikons Malta	-	60,276
90% Aksione Ikons shpk	900	900
100% Aksione Abkons Serbia	1,237,000	1,217,700
100% Aksione Ikons Serbia	1,237,000	1,217,700
100% Aksione Blessed Investment LTD	148,440	146,124
50% Aksione GBI	50,000	-
	<u>2,673,340</u>	<u>2,642,700</u>

11. Aktive afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019:

	<u>Toka, troje dhe terrene</u>	<u>Ndërtesa</u>	<u>Totali</u>
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2019	349,290,447	-	349,290,447
Shtesa	-	166,947,728	166,947,728
Gjendja më 31 dhjetor 2019	349,290,447	166,947,728	516,238,175
Pakësime			
Gjendja më 31 dhjetor 2020	66,874,556	-	66,874,556
Gjendja më 31 dhjetor 2020	282,415,891	166,947,728	449,363,619
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2019	-	-	-
Amortizimi i vitit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	-	-
Amortizimi i vitit	-	-	-
Pakësime	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	-	-	-
Vlera neto kontabël			
Gjendja më 31 dhjetor 2019	349,290,447	166,947,728	516,238,175
Gjendja më 31 dhjetor 2020	282,415,891	166,947,728	449,363,619

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Furnitorë në monedhë	2,461,794	319,258
	2,461,794	319,258

13. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrime tregtare ndaj palëve të lidhura	8,182,782	58,067,576
Detyrime të tjera ndaj palëve të lidhura	298,891,360	317,784,360
	307,074,142	375,851,936

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	38,637	3,346
Tatimi mbi te ardhurat personale	42,962	8,894
	<u>81,599</u>	<u>12,240</u>

15. Parapagime të marra

Parapagimet e marra më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Parapagime Fiori Di Bosco	655,404,372	473,695,182
	<u>655,404,372</u>	<u>473,695,182</u>

16. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Te tjera detyrime	1,685,072	-
Paga dhe shperblime	73,706	73,703
	<u>1,758,778</u>	<u>73,703</u>

17. Kapitali

Kapitali më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Numri i kuotave	1	1
Vlera nominale	7,000,100	7,000,100
	<u>7,000,100</u>	<u>7,000,100</u>

Fitimi i vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2020 është 117,176,114 lekë. (31 dhjetor 2019: 260,492,102lekë.)
 Fitimet e mbartura më 31 dhjetor 2020 janë 808,825,010 lekë. (31 dhjetor 2019: 548,332,908lekë.)

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	61,231,500	-
	<u>61,231,500</u>	<u>-</u>

19. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet për lëndën e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	66,874,556	-
	<u>66,874,556</u>	<u>-</u>

20. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime konsulence	1,765,891	255,528
Shpenzime qeraje	104,383	103,473
Shërbime të tjera	82,445	1,022,426
Udhetime dhe dieta	120,000	-
Konsulenca me zhvillim	127,667	-
Komisione bankare	166,654	148,348
Taksa të ndryshme	298,000	201,000
Shpenzime të tjera	129,953	-
Gjoha të ndryshme	25,033	6,552
	<u>2,820,026</u>	<u>1,737,327</u>

21. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime për paga	1,551,808	403,894
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	172,992	6,866
	<u>1,724,800</u>	<u>410,760</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2020 është 1 punonjës. (31 dhjetor 2019: 1 punonjës)

22. Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse

Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga dividendë-Abkons	117,621,000	251,581,484
	<u>117,621,000</u>	<u>251,581,484</u>

23. Shpenzime financiare (neto)

Shpenzimet financiare (neto) detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga interest	3,175,482	2,560,891
Të ardhura nga këmbimet valutore	6,567,514	8,497,814
	<u>9,742,996</u>	<u>11,058,705</u>

24. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	117,176,114	260,492,102
Total shpenzime të panjohura	25,033	6,552
Penalite, gjoba e dëmshpërblime	25,033	6,552
Te ardhura te patatueshme:		
Te ardhura nga dividend ne kompani te kontrolluarara	(117,621,000)	(251,581,484)
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<u>(419,853)</u>	<u>8,917,170</u>
Humbje fiskale e mbartur	-	(11,598,822)
<i>Fitim (humbje) para tatimit</i>	(419,853)	(2,681,652)
<i>Tatim fitimi @15%</i>	-	-
	<u><u>117,176,114</u></u>	<u><u>260,492,102</u></u>

25. Transaksionet me palët e lidhura

Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet, si dhe transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë si mëposhtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>		<u>31 dhjetor 2019</u>	
	<u>Të arkëtueshme</u>	<u>Të pagueshme</u>	<u>Të arkëtueshme</u>	<u>Të pagueshme</u>
Matrix Konstruksion detyrime tregtare	-	8,182,782	-	58,067,576
Matrix Konstruksion detyrime te tjera	-	298,891,360	-	317,784,360
Abkons	-	8,659	-	-
	-	<u><u>307,082,801</u></u>	-	<u><u>375,851,936</u></u>

25. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
<i>Divident për t'u shpërndarë</i>				
Abkons	28,928,944	-	50,880,374	-
Ikons	4,478,300	-	2,919,750	-
<i>Hua</i>				
Hua nga ortaku	18,555,000	-	18,265,500	-
Hua Afatshkurtër- Ikons Global Malta	3,153,732	-	3,044,250	-
Hua Afatshkurtër – GBI shpk	25,378,160	-	-	-
Hua Afatshkurtër – Renew shpk	34,636,000	-	-	-
Hua Afatshkurtër- Abkons Serbia	17,318,000	-	15,221,250	-
Hua Afatshkurtër- Albanian Financial Institution	131,634,200	-	126,454,471	-
Hua Afatgjatë- Ikons Shqipëria	26,719,200	-	26,302,320	-
Hua-ARC	39,534,000	-	14,612,400	-
Hua Afatshkurtër - Blue TDI	-	-	43,590,081	-
Hua Ikons DOO	1,237,000	-	1,217,700	-
	328,397,054	-	302,508,096	-
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Abkons		104,383		166,831,764
Albanian Financial Institution	3,175,482		2,560,891	
Matrix Konstruksion		133,982,231		171,689,557
	3,175,482	134,086,615	2,560,891	338,521,321

26. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

Blessed Investment sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

27. Ngjarje pas datës së bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

mazars

Str. Emin Duraku,
B. "Binjaket" No. 5
Tirana, Albania

Tel: +355 4 2222 889

Tel: +355 4 2278 015

www.mazars.al